



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2698, datë 17.11. 2016

Për

**Shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit Iva Elektronik sh.p.k., kundër masës administrative të dënimit me Gjobë.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj.Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj.Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj.Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Sara Reçi, në mbledhjen e datës 17.11.2016, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Shqyrtimi i ankimit administrativ të sipërmarrësit Iva Elektronik sh.p.k., kundër masës administrative të dënimit me Gjobë.**

**BAZA LIGJORE:**

1. Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918), i ndryshuar;
2. Ligji nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (Ligji nr. 44/2015);
3. Rregulloren nr. 34, datë 23.12.2014 për “Inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative”,

## K Ë SHILL I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e datës 21.10.2016 (nr. 1594/4Prot. i AKEP datë 24.10.2016), “Ankimim Gjobe” e sipërmarrësit Iva Elektronik sh.p.k.;
2. Urdhri i Inspektimit nr. 1861, datë 3.10.2016; Akti i Inspektimit me nr. 54 datë 11.10.2016 dhe Relacioni shoqërues; Gjoha nr. 54, datë 11.10.2016;
3. Korrespondenca me email dëguar sipërmarrësit Iva Elektronik sh.p.k.
4. Memo e datës 11.10.2016 e përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Frekuencave, cilësisë dhe inspektimit.
5. Relacion shpjegues (Relacioni);

si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

### V Ë R E N:

#### I.

- i. Ankimi i sipërmarrësit Iva Elektronik sh.p.k. i datës 21.10.2016, drejtuar Këshillit Drejtues për anulimin e gjobës së vendosur nga inspektorët e AKEP, është brenda afatit të parashikuar si dhe plotëson kushtet për praninë të ankimit të parashikuara në nenin 135 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë (Ligji nr. 44/2015, datë 30.4.2015).
- ii. Bazuar në Urdhrit e Inspektimit nr. 1861, datë 3.10.2016, është udhëruar kryerja e inspektimit tek sipërmarrësi i komunikimeve elektronike Iva Elektronik sh.p.k., për periudhën 3.10.2016 – 31.10.2016, me objekt:  
*Verifikimin e zbatimit të nenit 9, pika 1 e Rregullores Nr. 37 datë 29.10.2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”.*
- iii. Në zbatim të Urdhrit të lartpërmendur, grupi i inspektimit ka njoftuar përfaqësuesin ligjor të shoqërisë z. Ilir Kumbaro, me anë të postës elektronike më datë 10.3.2016, duke i dërguar edhe kopje të Urdhrit të inspektimit nr. 1861, datë 3.10.2016. Përfaqësuesit të sipërmarrësit, i është kërkuar krijimi i kushteve për kryerjen e inspektimit, konform nenit 12, të Rregullores nr. 34, datë 23.12.2014 për “Inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative” (këtu e më poshtë: *rregullore e inspektimit*).
- iv. Referuar materialeve të inspektimit: Urdhër inspektimit, Akt inspektimi, Fletë Gjobë, Relacion, korrespondenca me email, dhe aktet e tjera të depozituara në AKEP për këtë sipërmarrës, është konstatuar se:  
Sipërmarrësi Iva Elektronik sh.p.k., sipas Autorizimit Nr. 2012-AP-U255-8-14, datë 27.6.2012, është regjistruar për të ofruar:
  - A. *Rrjete publike të komunikimeve elektronike:*
    - *Rrjete publike tokësore fikse aksesit dhe transmetimi*
  - B. *Shërbimeve publike të komunikimeve elektronike:*
    - *Shërbime telefonike / Aksesit në internet etj.*
- v. Grupi i inspektimit ka verifikuar nëse, sipërmarrësi Iva Elektronik sh.p.k., ka zbatuar parashikimet e Ligjit nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e

Shqipërisë” i ndryshuar (këtu e në vijim: *ligji nr. 9918/2008*), dhe akteve të dala në zbatim të tij, Rregullores nr. 24, datë 02.02.2012 për “Autorizimin e Përgjithshëm”, dhe Rregullores nr. 37 datë 29.10.2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” dhe më konkretisht nenit 9 të kësaj rregulloreje.

- vi. Rregullorja për garantimin dhe sigurinë e rrjeteve, në nenin 9 të saj, përcakton detyrimin e sipërmarrësve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, për të dërguar informacion të detajuar për të vlerësuar sigurinë dhe/ose integritetin e shërbimeve dhe rrjeteve në AKEP periodikisht një herë në vit, brenda muajit Janar për vitin paraardhës, sipas Aneksit 3 të kësaj rregulloreje.
- vii. Në lidhje me këto detyrime sipas Aneksit 3, AKEP i ka informuar të gjithë sipërmarrësit, duke përfshirë edhe Iva Elektronik sh.p.k., me anë të shkresës nr. 2032Prot, datë 12.11.2015, duke iu kërkuar të sjellin informacionin dhe raportet e detajuara brenda datës 31.01.2016. Sipërmarrësi në këtë njoftim, është sqaruar edhe për formën e mënyrën e paraqitjes së raportimit, për përshkrimin e sistemeve, pajisjeve, masat e marra dhe zgjidhjet, për rrjetet me anë të të cilave ofron shërbimet publike të komunikimeve elektronike. Ky informacion është kërkuar të përcillet si në formë elektronike përmes modulit të aplikimeve “online”, ashtu edhe me shkresë zyrtare në AKEP.
- viii. Duke qenë se, informacioni i kërkuar si më lart nuk është depozituar në asnjë prej formave të këkuara dhe, as në afatin e kërkuar nga AKEP, nga sektori përkatës është vijuar me kujtesë me e-mail në datë 27.1.2016 dhe 27.10.2016, duke i vënë në dukje sipërmarrësit Iva Elektronik sh.p.k., për mospërbushjen e detyrimit.
- ix. Në këto njoftime, AKEP ka parajmëruar sipërmarrësin që, nëse brenda afatit të caktuar nuk janë përmbushur detyrimet ligjore, AKEP-it i lind e drejta të ndërmarrë të gjitha masat administrative që parashikon ligji nr. 9918/2008 dhe aktet rregullatore të nxjerra në zbatim të tij.
- x. Nga ky sipërmarrës theksojmë se, nuk ka patur asnjë përgjigje apo interesim, në lidhje me këtë kërkesë të AKEP, për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në ligj dhe në rregulloren përkatëse mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”.
- xi. Në përfundim, Grupi i inspektimit, pas verifikimit, ka konstatuar se:

Sipërmarrësi Iva Elektronik sh.p.k., duke mos zbatuar nenin 9, pika 1 të Rregullores nr. 37 datë 29.10.2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, ka kryer shkeljen e parashikuar në pikën 1, të nenit 135, kundravajtjet administrative, të ligjit nr. 9918/2008.

Për këtë shkelje të kryer nga sipërmarrësi Iva Elektroni sh.p.k., Grupi i inspektimit, bazuar në nenin 137, të ligjit nr. 9918/2008, nenit 35 të Rregullores së inspektimit, ka marrë vendim për dhënien e masës administrative “Gjobë” në vlerën 50 000 lekë.

Grupi i inspektimit, për rregullimin e shkeljes së konstatuar, i la detyrë sipërmarrësit Iva Elektronik sh.p.k., të bëjë menjëherë raportimin “Mbi zbatimin e detyrimeve për masat mbrojtëse dhe kushtet e sigurisë në komunikimet elektronike” për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike sipas Aneksit 3 të nenit 9 pika 1, të rregullores për inspektim/monitorim, brenda datës 31.10.2016.

## II.

AKEP, pasi shqyrtoi materialet pjesë përbërëse të dosjet së inspektimit, konstatimet dhe konkluzionet e arritura në përfundim të procesit të inspektimit, vlerëson se:

- i. Grupi i inspektimit në zbatim dhe konform me parashikimet e Rregullores nr. 34, datë 23.12.2015, për inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative” ka kryer veprimet proceduriale duke zhvilluar procedurë inspektuese.
- ii. Rezulton se, Grupi i inspektimit ka njoftuar paraprakisht përfaqësuesin e sipërmarrësit Iva Elektronik sh.p.k., me postë elektronike më datë 3.10.2016, duke i dërguar bashkëngjitur kopjen e Urdhrit të Inspektimit nr. 1543Prot., datë 22.9.2015.
- iii. Sa i takon shkeljeve të konstatuara nga inspektorët gjatë verifikimit, vërehet se, sipërmarrësi Iva Elektronik sh.p.k., edhe pse është njoftuar disa herë nga strukturat e posaçme të AKEP të ngarkuara për zbatimin e detyrimeve rregullatore, nuk ka zbatuar detyrimet që rrjedhin nga Rregullorja nr. 37 datë 29.10.2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”.
- iv. Mospërbushja nga sipërmarrësi Iva Elektronik sh.p.k., e detyrimeve të rregullores nr. 37, përbën gjithashtu, shkelje të parashikimeve të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, i ndryshuar, e konkretisht nenin 122, që përcakton: detyrimin e sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike për të zbatuar masa teknike dhe organizative, për të realizuar sigurime e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të ofruara prej tyre.
- v. Në njoftimet e kryera nga strukturat përgjegjëse të AKEP, rezulton se sipërmarrësit Iva Elektronik sh.p.k., i është lënë afat për përbushjen e detyrimeve, për të raportuar mbi marrjen dhe zbatimin masave teknike dhe organizative, për të realizuar sigurinë e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të ofruara prej tyre. Në lidhje me njoftimet e AKEP mbi këtë raportim, nga ky sipërmarrës nuk ka patur interesime apo përgjigje nga ky sipërmarrës.
- vi. Nga informacioni i marrë nga sektori i monitorim / inspektimit rezulton se, Iva Elektronik sh.p.k., në inspektimin e kryer më datë 13.2.2012, është gjetur në shkelje të nenit 65 të ligjit nr. 9918/2008 i ndryshuar, për përdorim të frekuencave pa autorizim të AKEP. Për këtë shkelje ndaj sipërmarrësit është marrë masa administrative Gjobë në vlerën 124.600 Lekë. Kjo gjobë rezulton e papaguar.
- vii. Për sa më lart u parashtrua, duke patur parasysh, shkeljet e konstatuara, të kryera nga sipërmarrësi Iva Elektronik sh.p.k., i cili nuk ka përbushur detyrimet të rregullores nr. 37, duke kryer edhe shkelje të parashikimeve të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, i ndryshuar, e konkretisht nenin 122, që përcakton: detyrimin e sipërmarrësve të rrjeteve dhe / ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike për të zbatuar masa teknike dhe organizative, për të realizuar sigurime e rrjeteve dhe / ose shërbimeve të ofruara prej tyre, shkelje për të cilat, Inspektorët, bazuar në 1) Ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 135/1, 137 paragrafi VII, dhe 2) Rregulloren nr. 34, datë 23.12.2014 për “Inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative”, neni 35, kanë të drejtë të vendosin gjobë dhe të kërkojnë marrjen e masave për ndreqjen e shkeljes.

- Në vijim, inspektorët kanë vendosur Gjobën nr. 54, datë 11.10.2016, në vlerën 50 000 lekë dhe i kanë lënë detyrë përmbushjen e këtij detyrimi brenda datës 31.10.2016.
- viii. Vendimi për vendosjen e Gjobës nr. 54, datë 11.10.2016, në vlerën 50 000 lekë dhe dokumentacioni në përbërje të Aktit të Inspektimit, i është dërguar sipërmarrësit Iva Elektronik sh.p.k me anë të njoftimit të AKEP dërguar me nr. 1594/3Prot, datë 12.10.2016.
- ix. Pas marrjes së njoftimit për vendosjen e Gjobës nr. 54, datë 11.10.2016, Sipërmarrësi Iva Elektronik sh.p.k. me shkresën e datës 21.10.2016 (nr. 1594/4Prot. i AKEP, datë 24.10.2016) me objekt “Ankim Gjoke”, i është drejtuar Këshillit Drejtues duke kërkuar anulimin e Gjobës nr. 54, datë 11.10.2016 të vendosur nga inspektorët e AKEP.
- x. Pas vlerësimit, Këshilli Drejtues, në zbatim të nenit 135, pika 4, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, i ndryshuar, ka vendosur thirrjen në seancë dëgjimore të sipërmarrësit Sipërmarrësi Iva Elektronik sh.p.k., për t’i dhënë mundësi të japë shpjegime, përpara marrjes së vendimit nga Këshilli Drejtues.
- xi. Sipërmarrësi Iva Elektronik sh.p.k. u njoftua me shkresën nr. 1594/5Prot, datë 2.11.2016, për zhvillimin e takimit. Më datë 9.10.2016, ora 12:00, në ambientet e AKEP, nga ana e sipërmarrësit Iva Elektronik nuk u paraqit asnjë përfaqësues. Pas verifikimit në zyrën e protokollit dhe në emailet zyrtare të AKEP, rezultoi që nuk kishte ndonjë kërkesë për shtyrje.
- xii. Rezulon që edhe brenda datës 31.10.2016, që ishte afat për përmbushjen e këtij detyrimi Iva Elektronik sh.p.k. nuk ka depozituar raportin e kërkuar nga AKEP mbi masat e marra për sigurinë e rrjeteve.
- xiii. Në lidhje me parashtrimet e paraqitura në ankim, AKEP arsyeton se, pretendimet e sipërmarrësit Iva Elektronik sh.p.k. në lidhje me datën e njoftuar të kryerjes së inspektimit, konstatohen të pabazuara sepse, në Urdhrin e Inspektimit të dërguar bashkëngjitur email-it, sipërmarrësi është njoftuar për datat e zhvillimit të inspektimit në paragrafin e parë të pjesës urdhëruese të udhrit: 3.10.2016-31.10.2016.
- xiv. Në lidhje me prezencën e inspektorëve të AKEP pranë ambienteve, shpjegojmë se nga ana e Iva Elektronik sh.p.k., pas marrjes së njoftimit për inspektim, nuk është kërkuar shtyrje e inspektimit për shkak të pamundësisë për të qënë i pranishëm ndonjë përfaqësues i autorizuar në zyrat e shoqërisë. Inspektorët janë paraqitur pranë zyrave dhe nuk kanë gjetur asnjë përfaqësues të sipërmarrësit.
- xv. Për objektin e këtij inspektimi: Verifikimin e zbatimit të nenit 9, pika 1 e Rregullores Nr. 37 datë 29.10.2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, jo domosdoshmërisht inspektorët duhet të hynin në ambientet e sipërmarrësit për të konstatuar shkeljen.
- Konstatimi shkeljes, pra të mosdërgimi i raportit të detajuar mbi masat e marra për sigurinë e rrjeteve në AKEP, është konstatuar nga të dhënat e depozituara në AKEP (si në në modulin e aplikimeve online, ashtu edhe në zyrën e protokollit) nga sektori përkatës, AKEP, përmes inspektimit në distancë të parashikuar në nenin 5 të Rregullores nr. 34, datë 23.12.2014. Edhe ky pretendim nuk është i bazuar dhe nuk përlligj mosprezencën e një përfaqësuesi të autorizuar nga sipërmarrësi.

- xvi. Në përfundim të procedurës për shqyrtimin e ankimit dhe të pretendimeve të sipërmarrësit ankimues Iva Elektronik sh.p.k., pas arsytimit në aktet e paraqitura nga Grupi i Inspektimit, si dhe nga analiza e plotë e çështjes objekt shqyrtimi, arsyetohet se, vendosja e masës administrative “Gjobë” (nr. 54, datë 11.10.2016) sipërmarrësit Iva Elektronik sh.p.k., përlligjet administrativisht, pasi është e bazuar në dispozitat materiale dhe proceduriale të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar dhe Rregullores nr. 34, datë 23.12.2014, “Për inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative” si tillë duhet të mbetet në fuqi.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe në pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918/2008 i ndryshuar, dhe në zbatim nenit 130 e në vijim të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë,

## **V E N D O S :**

1. Refuzimin e ankimit të sipërmarrësit Iva Elektronik sh.p.k. të paraqitur me shkresën nr. 1594/4Prot. i AKEP, datë 24.10.2016 dhe lënien në fuqi të masës administrative “Gjobë” me nr. 54, datë 11.10.2016
2. Të njoftohet sipërmarrësi Iva Elektronik sh.p.k. për zbatimin e këtij Vendimi;
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Tiranës, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij vendimi.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

## **ANËTARË:**

- |                   |                 |
|-------------------|-----------------|
| <b>1. Alban</b>   | <b>KARAPICI</b> |
| <b>2. Anila</b>   | <b>DENAJ</b>    |
| <b>3. Ketrin</b>  | <b>TOPÇIU</b>   |
| <b>4. Klarina</b> | <b>ALLUSHI</b>  |